

# LIGJI PËR ORGANIZIMIN TERRITORIAL TË VETADMINISTRIMIT LOKAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË

## I. DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

### Neni 1

Me këtë ligj: rregullohet organizimi territorial i vetadministrimit lokal në Republikën e Maqedonisë; themelohen komunat si njësi të vetadministrimit lokal; përcaktohen rajonet e komunave dhe të Qytetit të Shkupit si njësi e veçantë e vetadministrimit lokal; përcaktohen emrat, selitë dhe kufijtë e komunave; përcaktohen lloji dhe emrat e vendbanimeve; rregullohet bashkëngjitja, ndarja dhe ndryshimi i kufijve të komunave dhe të Qytetit të Shkupit, si dhe çështje të tjera të organizimit territorial të vetadministrimit lokal.

### Neni 2

Themelimi i komunës së re (bashkëngjitja, ndarja dhe ndryshimi i kufijve) dhe ndryshimi i emrit dhe i selisë së komunës, mund të bëhet me ndryshimin dhe plotësimin e këtij ligji, pas konsultimit paraprak me qytetarët e rajonit të komunave të cilin i dedikohet bashkëngjitja, ndarja ose ndryshimi, në mënyrën e rregulluar me ligj.

### Neni 3

Rajoni i komunës përfshin një ose më tepër vendbanime me komuna kadastrale të përcaktuara në pajtim me ligjin. Rajonin e Qytetit të Shkupit, si njësi e veçantë e vetadministrimit lokal, e përbëjnë rajonet e komunave të qytetit të Shkupit.

### Neni 4

Kufij të komunës janë kufijtë e komunave kadastrale të vendbanimeve në përbërjen e saj, në pjesën që kufizohen me komunat fqinje, ose përrputhen me kufirin shtetëror të Republikës së Maqedonisë. Kufiri i Qytetit të Shkupit, si njësi e veçantë e vetadministrimit lokal, janë kufijtë e komunave në qytetin e Shkupit, në pjesën që kufizohen me komunat fqinje ose përrputhen me kufirin shtetëror të Republikës së Maqedonisë.

### Neni 5

Secila komunë ka emër dhe seli të komunës. Selia e komunës është në njërin nga vendbanimet që janë në përbërje të saj. Selia e komunave në qytetin e Shkupit është në qytetin e Shkupit.

### Neni 6

Vendbanime janë qytetet dhe fshatrat. Qytet, sipas këtij ligji, është vendbanimi që ka më shumë se 3 000 banorë; ka strukturë të zhvilluar të veprimtarive, ndërsa mbi 51% të të punësuarve janë jashtë veprimtarive primare; ka fizionomi të ndërtuar urbane me zona banimi, ekonomike, rekreacioni dhe gjelbrim publik, shesh, sistem të ndërtuar të rrugëve dhe shërbimeve komunale dhe paraqet qendër funksionale të vendbanimeve që e rrethojnë. Fshat, sipas këtij ligji, është vendbanimi me rëndësi njëfunksionale në të cilin dominon një veprimtari, ndërsa rajoni është me fizionomi dhe funksion agrar. Vendbanimet përcaktohen me këtë ligj.

### **Neni 7**

Kufiri i qytetit, si vendbanim, përcaktohet me planin e përgjithshëm urbanistik. Kufiri i fshatit, si vendbanim, përcaktohet me planin e përgjithshëm për vendbanimin.

### **Neni 8**

Secili vendbanim ka emër. Në rajonin e një komune, dy ose më tepër vendbanime, sipas rregullës, nuk mund të kenë emër të njëjtë.

### **Neni 9**

Vendbanimi dhe komuna e tij kadastrale mund të jenë në përbërje të vetëm një komune.

## **II. KOMUNAT NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

### **Neni 10**

Në Republikën e Maqedonisë themelohen dhe përcaktohen emrat dhe selitë e këtyre komunave:

a) Komunat me seli në qytet

1. Komuna e Berovës

me seli në qytetin Berovë;

2. Komuna e Manastirit

me seli në qytetin Manastir;

3. Komuna e Bogdancit

me seli në qytetin Bogdancë;

4. Komuna e Vallandovës

me seli në qytetin Vallandovë;

5. Komuna e Velesit

me seli në qytetin Veles;

6. Komuna e Vinicës

me seli në qytetin Vinicë;

7. Komuna e Gjevgjeli

me seli në qytetin Gjevgjeli;

8. Komuna e Gostivarit

me seli në qytetin Gostivar;

9. Komuna e Dibrës

me seli në qytetin Dibër;

10. Komuna e Dellçevës

me seli në qytetin Dellçevë;

11. Komuna e Demir Kapisë  
me seli në qytetin Demir Kapi;
12. Komuna e Demir Hisarit  
me seli në qytetin Demir Hisar;
13. Komuna e Kavadarit  
me seli në qytetin Kavadar;
14. Komuna e Kërçovës  
me seli në qytetin Kërçovë;
15. Komuna e Koçanit  
me seli në qytetin Koçan;
16. Komuna e Kratovës  
me seli në qytetin Kratovë;
17. Komuna e Kriva Pallankës  
me seli në qytetin Kriva Pallankë;
18. Komuna e Krushevës  
me seli në qytetin Krushevë;
19. Komuna e Kumanovës  
me seli në qytetin Kumanovë;
20. Komuna e Makedonska Kamenicës  
me seli në qytetin Makedonska Kamenicë;
21. Komuna e Makedonski Brodit  
me seli në qytetin Makedonski Brod;
22. Komuna e Negotinës  
me seli në qytetin Negotinë;
23. Komuna e Ohrit  
me seli në qytetin Ohër;
24. Komuna e Pehçevës  
me seli në qytetin Pehçevë;
25. Komuna e Prilepit  
me seli në qytetin Prilep;
26. Komuna e Probishtipit  
me seli në qytetin Probishtip;
27. Komuna e Radovishit  
me seli në qytetin Radovish;

28. Komuna e Resnjës  
me seli në qytetin Resnjë;
29. Komuna e Sveti Nikollës  
me seli në qytetin Sveti Nikollë;
30. Komuna e Strugës  
me seli në qytetin Strugë;
31. Komuna e Strumicës  
me seli në qytetin Strumicë;
32. Komuna e Tetovës  
me seli në qytetin Tetovë; dhe
33. Komuna e Shtipit  
me seli në qytetin Shtip;

b) Komunat me seli në fshat:

34. Komuna e Haraçinës  
me seli në fshatin Haraçinë;
35. Komuna e Bosillovës  
me seli në fshatin Bosillovë;
36. Komuna e Bërvenicës  
me seli në fshatin Bërvenicë;
37. Komuna e Vasilevës  
me seli në fshatin Vasilevë;
38. Komuna e Vevçanit  
me seli në fshatin Vevçan;
39. Komuna e Vraneshticës  
me seli në fshatin Vraneshticë;
40. Komuna e Vrapçishtit  
me seli në fshatin Vrapçisht;
41. Komuna e Gradskos  
me seli në fshatin Gradsko;
42. Komuna e Debarcës  
me seli në fshatin Bellçishtë;
43. Komuna e Dojranit  
me seli në fshatin Dojran i Vjetër;

44. Komuna e Dollnenit  
me seli në fshatin Dollnen;
45. Komuna e Drugovës  
me seli në fshatin Drugovë;
46. Komuna e Zhelinës  
me seli në fshatin Zhelinë;
47. Komuna e Zajazit  
me seli në fshatin Zajaz;
48. Komuna e Zelenikovës  
me seli në fshatin Zelenikovë;
49. Komuna e Zërnovcit  
me seli në fshatin Zërnovc;
50. Komuna e Ilindenit  
me seli në fshatin Ilinden;
51. Komuna e Jegunovcit  
me seli në fshatin Jegunovcë;
52. Komuna e Bogovinës  
me seli në fshatin Bogovinë;
53. Komuna e Karbincit  
me seli në fshatin Karbinc;
54. Komuna e Konçes  
me seli në fshatin Konçe;
55. Komuna e Krivogashtanit  
me seli në fshatin Krivogashtan;
56. Komuna e Likovës  
me seli në fshatin Likovë;
57. Komuna e Llozovës  
me seli në fshatin Llozovë;
58. Komuna e Mavrovës dhe Rostushës  
me seli në fshatin Rostushë;
59. Komuna e Mogillës  
me seli në fshatin Mogillë;
60. Komuna e Novacit  
me seli në fshatin Novac;

61. Komuna e Novo Sellës  
me seli në fshatin Novo Sellë;
62. Komuna e Oslloresë  
me seli në fshatin Oslloresë;
63. Komuna e Petrovecit  
me seli në fshatin Petrovec;
64. Komuna e Pllasnicës  
me seli në fshatin Pllasnicë;
65. Komuna e Rankovcit  
me seli në fshatin Rankovc;
66. Komuna e Rosomanit  
me seli në fshatin Rosoman;
67. Komuna e Sopishtës  
me seli në fshatin Sopishtë;
68. Komuna e Nagoriçanit të Vjetër  
me seli në fshatin Nagoriçan i Vjetër;
69. Komuna e Studeniçanit  
me seli në fshatin Studeniçan;
70. Komuna e Tearcës  
me seli në fshatin Tearcë;
71. Komuna e Qendrës Zhupë  
me seli në fshatin Qendër Zhupë;
72. Komuna e Çashkës  
me seli në fshatin Çashkë;
73. Komuna e Çeshinovës  
me seli në fshatin Çeshinovë; dhe
74. Komuna e Çuçer-Sandevës  
me seli në fshatin Çuçer-Sandevë;

c) Komunat në Qytetin e Shkupit

75. Komuna Aerodrom  
me seli në Qytetin e Shkupit;
76. Komuna Butel  
me seli në Qytetin e Shkupit;

77. Komuna Gazi Babë  
me seli në Qytetin e Shkupit;
78. Komuna Gjorçe Petrov  
me seli në Qytetin e Shkupit;
79. Komuna Karposh  
me seli në Qytetin e Shkupit;
80. Komuna Kisella Vodë  
me seli në Qytetin e Shkupit;
81. Komuna Saraj  
me seli në Qytetin e Shkupit;
82. Komuna Qendër  
me seli në qytetin e Shkupit;
83. Komuna Çair  
me seli në qytetin e Shkupit; dhe
84. Komuna Shuto Orizare  
me seli në qytetin e Shkupit

### **III. RAJONI I KOMUNAVE DHE VENDBANIMET NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

#### **Neni 11**

Rajonin e komunave nga neni 10 nën a) dhe nën b) të këtij ligji, e përbëjnë komunat kadastrale të vendbanimeve në përbërje të tyre. Rajonin e komunave nga neni 10 nën c) të këtij ligji, e përbëjnë komunat kadastrale të vendbanimeve në përbërjen e tyre dhe pjesa e qytetit të Shkupit si vendbanim, në kufijtë e përcaktuar me Ligjin për qytetin e Shkupit.

#### **Neni 12**

Në komunat nga neni 10 i këtij ligji përcaktohen këto vendbanime:

1. Komuna e Haraçinës – fshatrat: Haraçinë, Grushinë, Majancë dhe Orllancë.
2. Komuna e Berovës – qyteti Berovë dhe fshatrat: Budinarc, Vlladimirovë, Dvorishtë, Maçevë, Mitrashinc, Ratevë, Rusinovë dhe Smojmrovë.
3. Komuna e Manastirit – qyteti Manastir dhe fshatrat: Bareshan, Bisticë, Bratin Doll, Brusnik, Bukovë, Vellushinë, Gaballavc, Gopesh, Egri i Epërm, Orizare e Epërme, Graeshnicë, Dihovë, Dolenc, Egri i Poshtëm, Orizare e Poshtme, Dragarinë, Dragozhan, Dragosh, Drevenik, Gjavatë, Zhaben, Zllokuqan, Kazhan, Kaninë, Karaman, Kishavë, Kravar, Kërklinë, Kremenicë, Kërstoar, Kukureçan, Llavec, Llazhec, Lerë, Lisollaj, Llogovardë, Llopaticë, Magarevë, Mallovishtë, Metimir, Mexhitli, Nizhepolë, Zmirnova e Re, Oblakovë, Olleven, Optiçar, Orehovë, Ostrec, Poeshevë, Porodin, Ramnë, Rashtan, Rotinë, Svinishtë, Sekiran, Snegovë, Egri i Mesëm, Sërpc, Zmirnovë e Vjetër, Strezhevë, Tërë, Tërnovë, Capar, Cërnobuk dhe Cërnovec;
4. Komuna e Bogdancit – qyteti Bogdanc dhe fshatrat: Gjavatë, Selemlë dhe Stajkovë,

5. Komuna e Bosilevës – fshatrat: Borievë, Bosilevë, Geçerli, Dërvosh, Ednokuqevë, Illovicë, Monospitovë, Petralinc, Radovë, Robovë, Saraj, Sekirnik, Balldovc i Vjetër, Turnovë, Hamzali dhe Shtukë;

6. Komuna e Bërvenicës – fshatrat: Bllacë, Bërvenicë, Vollkovi, Gurgurnicë, Sedllarc i Poshtëm, Miletinë, Radiovc, Stençë, Tenovë dhe Çellopek;

7. Komuna e Vallandovës – qyteti Vallandovë dhe fshatrat: Ajranli, Arazli, Bajrambos, Balinc, Barakli, Bashali, Bashibos, Brajkovc, Bulluntuli, Vejseli, Gradec, Gërçishtë, Dedeli, Gjuleli, Josifovë, Kazandoll, Koçuli, Marvinc, Piravë, Pllavush, Përsten, Rabrovë, Sobri, Tatarli, Terzeli, Udovë, Çallakli dhe Çestevë;

8. Komuna e Vasilevës – fshatrat: Angellc, Varvaricë, Vasilevë, Visoka Mëhalla e Lartë, Vlladievç, Gradoshorc, Dobroshinc, Dukatinë, Edrenikovë, Kushkuli, Niviçinë, Mëhalla e Re, Piperevë, Radiçevë, Sedllarc, Sushevë, Trebiçinë dhe Çanakli;

9. Komuna e Vevçanit - fshati Vevçan;

10. Komuna e Velesit – qyteti Veles dhe fshatrat: Bashino Sellë, Belleshtevicë, Buzallkovë, Veterskë, Kallasllar i Epërm, Orizare e Epërme, Kallasllar i Poshtëm, Orizare e Poshtme, Ivankovc, Karabunjisht, Krushje, Kumarinë, Llugunc, Mamutçevë, Novaçan, Novo Sellë, Oraovec, Otovicë, Rashtan, Rëllevc, Rudnik, Sëllp, Sllivnik, Sojakllar, Sopot, Cërkinë, Çalloshevë dhe Xhidimirc;

11. Komuna e Vinicës – qyteti Vinicë dhe fshatrat: Bllatec, Kërshlla e Vinicës, Gradec, Gërlan, Dragobrashtë, Istibanjë, Jakimovë, Kalimanc, Krushevë, Llak, Lesk, Lipeç, Peklan, Tërsinë dhe Cërn Kamen;

12. Komuna e Vraneshticës – fshatrat: Atishtë, Biçor Dollenc, Vraneshticë, Dupjan, Karbunicë, Koziçinë, Krushicë, Miokaz, Orllancë, Patec, Rabetinë, Reçani i Çellopekut, Svetoraç, Staroec dhe Çellopec;

13. Komuna e Vrapçishtit – fshatrat: Vranovc, Vrapçisht, Gallatë, Gradec, Gorjan, Dobri Doll, Gjurgjevishtë, Zubovc, Kalishtë, Llomnicë, Negotinë e Pollogut, Novo Sellë, Pozharan, Senokos dhe Toplicë;

14. Komuna e Gjevgjelisë – qyteti Gjevgjeli dhe fshatrat: Bogorodicë, Gabrovë, Davidovë, Kovanc, Korskë, Moin, Miletkovë, Miravc, Mërzenc, Negorc, Novo Konjskë, Petrovë, Përdejc, Sermenin, Smokvicë dhe Humë;

15. Komuna e Gostivarit – qyteti Gostivar dhe fshatrat: Balind Doll, Bellovishtë, Brodec, Vërtok, Banjicë e Epërme, Jellovcë e Epërme, Gjonovicë e Epërme, Debresh, Banjicë e Poshtme, Jellovcë e Poshtme, Gjonovicë e Poshtme, Zhelezna Rekë, Zdunjë, Koritë, Kunovë, Llakavicë, Leshnicë, Turçan i Vogël, Mirditë, Mitroj Kërsti, Padalishtë, Peçkovë, Simnicë, Sërmnovë, Sushicë, Strajan, Raven, Reçan, Tërnovë, Tumçevishtë, Qafë, Forinë, Çajllë dhe Çegran;

16. Komuna e Gradskos – fshatrat: Viniçan, Vodovrat, Çiçevë e Epërme, Gradsko, Gërçishtë, Dvorishtë, Çiçevë e Poshtme, Zgropollc, Koçillar, Kuridere, Nogaevc, Podles, Sveqan, Skaçinc, Ubogë dhe Ullanc;

17. Komuna e Dibrës – qyteti Dibër dhe fshatrat: Banishtë, Bomovë, Gari, Kosovrast i Epërm, Kosovrast i Poshtëm, Konjarë, Krivcë, Mogorçë, Osoj, Otishan, Rajçicë, Sellokuq, Spas, Tatar Elevc, Tërnaniq, Hame dhe Xhepishhtë;

18. Komuna e Debërcës – fshatrat: Arbinovë, Bellçishtë, Botun, Brezhan, Vellmej, Volinë, Vërbjan, Godivjë, Gorencë, Sredorek i Epërm, Gërko Polë, Sredorek i Poshtëm, Zlllest, Izdegllavje, Klimeshtan, Llaktinjë, Leshan, Mesheishtë, Mramorec, Novo Sellë, Ozdollen, Orovnik, Pesoçan, Sllatinë, Çifliku i Sllatinës, Slivovë, Soshan, Trebenishtë, Turje dhe Cërvena Vodë;

19. Komuna e Dellçevës – qyteti i Dellçevës dhe fshatrat: Bigllë, Vetren, Virçë, Vratissllavc, Gabrovë, Grad, Dramçë, Zvegor, Iliovë, Kiselicë, Kosovo Dabje, Istevnik i Ri, Oçipallë, Poletë, Razllovc, Sellnik, Stamer, Istvenik i Vjetër, Trabotivishtë, Turi dhe Çiflik;

20. Komuna e Demir Kapisë – qyteti Demir Kapi dhe fshatrat: Barovë, Besvicë, Bistrenc, Draçevicë, Dren, Iberli, Klisurë, Kosharkë, Koprishnicë, Koreshnicë, Përzhdëvë, Stërmashevë, Çelevec dhe Çiflik;



21. Komuna e Demir Hisarit – qyteti Demir Hisar dhe fshatrat: Babinë, Bazernik, Barakovë, Bellçë, Boishtë, Brezovë, Vardinë, Vellmevc, Virovë, Ilinë e Madhe, Graishtë, Dolenc, Edinakovc, Zhvan, Zhelezhec, Zhurçë, Zagoriç, Zashllë, Koçishtë, Kutretinë, Leskovë, Ilinë e Vogël, Mrenogë, Novo Sellë, Obednik, Pribillc, Radovë, Rakitnicë, Rastojcë, Svetë, Slladuevë, Slepçë, Slloeshticë, Smilevë, Sopotnicë, Strugovë, Suvo Gërll, Suvodoll, Utovë dhe Cerovë;

22. Komuna e Dojranit – fshatrat: Durutli, Gjoççeli, Kurtamzali, Nikoliq, Dojran i Ri, Organxhali, Sevendekli, Sretenovë, Dojran i Vjetër, Furkë, Cërniçan, Çausli dhe Xhumabos;

23. Komuna e Dollnenit – fshatrat: Bello Polë, Braillovë, Vrançë, Gorno Sellë, Gostirazhn, Dabjan, Debreshtë, Desovë, Dollgaec, Dollnen, Drenovc, Dupjaçan, Zhabjan, Zhitoshë, Zabërçan, Zapollzhan, Zërzë, Kostinc, Koshinë, Kutleshevë, Llazhan, Llokven, Mallo Mramoran, Margar, Nebregovë, Novosellan, Peshtalevë, Rilevë, Ropotovë, Sarandinovë, Sekircë, Senokos, Slepçë, Slivjë, Sredorek, Strovi dhe Cërnilishtë;

24. Komuna e Drugovës – fshatrat: Belicë, Bërzhdan, Vidran, Cërskë e Madhe, Dushegubicë e Epërme, Dobrenoec i Epërm, Dushegubicë e Poshtme, Dobrenoec i Poshtëm, Drugovë, Ehloec, Ivançishtë, Izvor, Javorec, Judovë, Klladnik, Kllenoec, Kozicë, Llavçan, Mallkoec, Cërskë e Vogël, Dolenc i Manastirit, Podvis, Popoec, Popollzhan, Prostranj, Svinjishtë, Sërbjan dhe Cer;

25. Komuna e Zhelinës – fshatrat: Leshnicë e Epërme, Grupçin, Dobarc, Leshnicë e Poshtme, Zhelinë, Kopaçin Doll, Llarçë, Llukovicë, Merovë, Novo Sellë, Ozormishtë, Pallaticë, Roglë, Sallarevë, Strimnicë, Trebosh, Cerovë dhe Çiflik;

26. Komuna e Zajazit – fshatrat: Baçishtë, Bukojçan, Strogomishtë e Epërme, Greshnicë, Dllapkin Doll, Strogomishtë e Poshtme, Zajaz, Kollarë, Kolibarë, Leshnicë, Midincë, Reçan i Zajazit dhe Tajmishtë;

27. Komuna e Zelenikovës – fshatrat: Vrazhallë, Gradovc, Gumalevë, Dejkovec, Dobrinë, Zelenikovë, Novo Sellë, Oreshan, Pakoshevë, Paligrad, Smesnicë, Strahojadicë, Taor dhe Tisovicë;

28. Komuna e Zërnovcit – fshatrat: Vidovishtë, Zërnovc dhe Morodvis;

29. Komuna e Ilindenit – fshatrat: Ajvatovc, Bujkovc, Bunarxhik, Buçinc, Deladrovç, Ilinden, Kadinë, Marinë, Milladinovc, Mralinë, Mërshevc dhe Tekija;

30. Komuna e Jegunovcit – fshatrat: Bellovishtë, Vratnicë, Zhillçë, Jazhincë, Jançishtë, Jegunovc, Kopancë, Orashje, Podbreg, Prelubishtë, Raotincë, Ratajë, Rogaçevë, Siriçinë, Staro Sellë, Tudencë dhe Shemshovë;

31. Komuna e Kavadarit – qyteti Kavadar dhe fshatrat: Begnishtë, Bojançishtë, Bohullë, Brushan, Bunarç, Vatashë, Vozarc, Galishtë, Garnikovë, Glisliq, Boshavë e Epërme, Gërbovec, Dabnishtë, Dobrotinë, Boshavë e Poshtme, Dragozhel, Dradnjë, Drenovë, Kesendre, Klinovë, Konopishtë, Koshan, Kërnjevë, Kumaniçevë, Majden, Marenë, Mrezhiçkë, Pravednik, Rëzhanovë, Radnjë, Raec, Resavë, Rozhden, Sopot, Stragovë, Farish, Çemerskë, Sheshkovë dhe Shivec;

32. Komuna e Bogovinës – fshatrat: Bogovinë, Pallçishtë e Epërme, Sedllarc i Epërm, Pallçishtë e Poshtme, Jellovjan, Kamjan, Zherovjan, Novaq, Novo Sellë, Pirok, Rakovec, Sellca e Keqe, Siniçan dhe Urviç;

33. Komuna e Karbincës – fshatrat: Argulicë, Batanjë, Vërteshkë, Gaber i Madh, Ballvan i Epërm, Trogerc, Ballvan i Poshtëm, Trogerc i Poshtëm, Ebepli, Junuzli, Kallauzli, Karbincë, Kepekçeli, Kozjak, Krupishtë, Kurfali, Kuçilat, Kuçicë, Gaber i Vogël, Miçak, Muratli, Karaorman i Ri, Oxhali, Pripeçan, Përnali, Radanj, Rulak, Tarinc dhe Cërvulevë;

34. Komuna e Kërçovës – qyteti Kërçovë dhe fshatrat: Knezhinë, Llazarovc, Mamudovc, Osoj, Rashtan dhe Trapçin Doll;

35. Komuna e Konçës – fshatrat: Gabrevc, Garvan, Vrashticë e Epërme, Lipoviq i Epërm, Dedinë, Vrashticë e Poshtme, Lipoviq i Poshtëm, Radesh i Poshtëm, Zagorc, Konçë, Lubnicë, Negrenovc, Rakitec dhe Skorushë;

36. Komuna e Koçanit – qyteti Koçan dhe fshatrat Bezikovë, Beli, Vraninc, Podlog i Epërm, Gratçe e Epërme, Gllavovicë, Gërdovc, Podlog i Poshtëm, Gratçe e Poshtme, Jastrebnik, Kostin Doll, Leshk, Mojanc, Nebojan, Niviçan, Novo Sellë, Orizare, Pantelej, Pashaxhikovë, Polak, Presekë, Pribaçevë, Pripor, Rajçan, Reçan, Tërkanj dhe Cërvena Nivë;

37. Komuna e Kratovës – qyteti Kratovë dhe fshatrat: Blizanc, Vakuf, Kratovë e Epërme, Dimoncë, Emiricë, Zheleznicë, Zhivalevë, Kavrak, Ketenovë, Knezhevë, Kojkovë, Konjuh, Krillaticë, Kuklicë, Kunovë, Llukovë, Mushkovë, Nezhilevë, Pendak, Prikovc, Sekulicë, Stracin, Tallamshanc, Tatomir, Topolloviq, Tërnovac, Turalevë, Filipovc, Shlegovë dhe Shopsko Rudare;

38. Komuna e Kriva Pallankës – qyteti Kriva Pallankë dhe fshatrat: Bës, Bashtevë, Borovë, Varovishtë, Gabar, Cërçoria e Madhe, Gradec, Dllaboçicë, Dobrovnice, Drenak, Drenjë, Duraçka Rekë, Zhidillovë, Kiselicë, Konopnicë, Kostur, Kosharë, Kërkle, Kërstov Doll, Llozanovë, Llukë, Cërçoria e Vogël, Martinicë, Metezhevë, Mozhdivnjak, Nerav, Ogut, Osiçë, Podërzhi Konj, Stanc, Tëllminc, Tërnovë dhe Uzem;

39. Komuna e Krivogashtanit – fshatrat: Bella Cërkv, Borotinë, Vogjan, Vërbjan, Godivjë, Korenicë, Krivogashtan, Krushean, Mirçe Acev, Obërshan, Pashino Ruvç, Podvis dhe Sllavej;

40. Komuna e Krushevës – qyteti Krushevë dhe fshatrat: Alldanc, Arilevë, Bellushinë, Birinë, Borinë, Buçin, Vërboec, Divjaci i Epërm, Divjaci i Poshtëm, Jakrenovë, Milloshevë, Norovë, Ostrillc, Presip, Pusta Rekë, Sazhdevë, Sveto Mitran dhe Sellcë;

41. Komuna e Kumanovës – qyteti Kumanovë dhe fshatrat: Agino Sellë, Bedinjë, Bellakovc, Bilanovc, Bërzak, Vakëf, Vincë, Gabresh, Kojnare e Epërme, Gradishtë, Dllëg, Dobroshan, Dovezencë, Kojnare e Poshtme, Zhivenjë, Zubovc, Jaçincë, Karabiçan, Kleçovcë, Kokoshinjë, Kolickë, Kosmatac, Kutlibeg, Kuçkarevë, Këshanj, Llopat, Lubodrag, Murgash, Novo Sellë, Novosellan, Orashac, Pezovë, Proevcë, Pçinjë, Rezhanovc, Reçicë, Ramanli, Skaçkovc, Sopot, Studena Barë, Sushevë, Tabanovc, Tromeqjë, Umin Doll, Çerkez, Çetircë dhe Shupli Kamen;

42. Komuna e Likovës – fshatrat: Allashec, Bellanoc, Vaksincë, Vishticë, Gllazhnjë, Goshincë, Dumanoc, Zllakuqan, Izvor, Likovë, Llojan, Mateç, Nakushtak, Opajë, Orizare, Hotël, Èrkoc, Ropalcë, Runicë, Sllupçan, Strazhë dhe Strimë;

43. Komuna e Llozovës – fshatrat: Axhibegovë, Axhimatovë, Bekirlija, Dorfulija, Gjuzemec, Karatmanovë, Kishino, Llozovë, Milinë, Samazalinë dhe Qoselari;

44. Komuna e Mavrovës dhe Rostushës – fshatrat: Axhievç, Belicë, Bibaj, Bitushë, Bogdevë, Boletin, Velebërd, Vollkovi, Vidushë, Vërben, Vërbjan, Galiçnik, Grekaj, Duf, Zhironicë, Zhuzhnjë, Jançë, Kiçinicë, Krakornicë, Leunovë, Llazaropole, Hanet e Mavrovës, Mavrovë, Nivishtë, Nikiforovë, Nistrovë, Niçpur, Novo Sellë, Orqushë, Prisojnicë, Rosok, Rostushë, Ribnicë, Sellcë, Sencë, Skudrinjë, Sretkovë, Sushicë, Tanushë, Trebishtë, Tresonç dhe Cerovë;

45. Komuna e Makedonska Kamenicës – qyteti Makedonska Kamenicë dhe fshatrat: Dulicë, Kosevicë, Kostin Doll, Llukovicë, Moshticë, Sasë, Todorovc dhe Cer;

46. Komuna e Makedonski Brodit – qyteti Makedonski Brod dhe fshatrat: Belicë, Bençë, Bitovë, Blizansk, Breznicë, Brest, Vir, Volçë, Manastirec i Epërm, Botushje e Epërme, Krushje e Epërme, Greshnicë, Deviç, Manastirec i Poshtëm, Botushje e Poshtme, Krushje e Poshtme, Dragov Doll, Drenovë, Zagrad, Zveçan, Zdunje, Zërkle, Izhishtë, Inçë, Kallugjerc, Kovaç, Kovçë, Kosovë, Krapë, Llatovë, Llovakicë, Llupshte, Mogilec, Modrishtë, Oreovec, Ramne, Rastesh, Rusjac, Samokov, Sllanskë, Sllatinë, Staro Sellë, Suvodoll, Sushicë, Tazhevë, Tomino Sellë, Topollnicë, Trebinë, Trebovle dhe Creshnevë;

47. Komuna e Mogillës – fshatrat: Alinc, Beranc, Budakovë, Vasharejcë, Çarlilja e Epërme, Çarlilja e Poshtme, Dedebalc, Dobrushevë, Sërpci i Poshtëm, Ivanjevç, Lloznan, Mogillë, Mojnë, Musinc, Novoselan, Noshpal, Podinë, Puturus, Radobor, Sveto Todor, Trap, Tërnovc dhe Cërniçan;

48. Komuna e Negotinës – qyteti Negotinë dhe fshatrat: Brusnik, Veshje, Vojshanc, Disan i Epërm, Disan I Poshtëm, Dubrovë, Janoshevë, Kallanjevë, Krivollak, Kuri, Lipë, Pepelishhtë, Peshternicë, Timjanik, Tremnik, Crveni Bregovi, Xhidimirc dhe Sheobë;

49. Komuna Novaci – fshatrat: Armatush, Balldovenc, Baç, Bilanik, Bërnik, Brod, Budimirc, Velesellë, Vranjevc, Germijan, Gneotinë, Gnilezh, Agllarc i Epërm, Gradeshnicë, Grumaz, Grunishtë, Dallbegovc, Dobroven, Dobromir, Agllarc i Poshtëm, Orehovë e Poshtme, Zhivojnë, Zoviq 1, Zoviq 2, Iven, Makovë, Meglenc, Novac, Novo Sellë, Orle, Parallovë, Petalinë, Pollog, Rapesht, Ribarc, Skoçivir, Slivicë, Soviq, Staravinë, Suvo Doll dhe Tepavc;

50. Komuna e Novo Sellës – fshatrat: Badolen, Bajkovë, Barbarevë, Borisovë, Drazhevë, Zubovë, Koleshinë, Mokrievë, Mokrinë, Konjarevë e Re, Novo Sellë, Samoillovë, Smollar, Konjarevë e Vjetër, Stinik dhe Sushicë;

51. Komuna e Oslomesë – fshatrat: Arangell, Berikovë, Garan, Zhubrinë, Jagoll, Jagoll Dollenc, Novo Sellë, Oslomej, Papradishtë, Popovjan, Premkë, Sërbicë, Strellcë, Tuhin, Cërvivc dhe Shutovë;

52. Komuna e Ohrit – qyteti Ohër dhe fshatrat: Vapillë, Vellgosht, Velevostovë, Llakocërej i Epërm, Konjskë e Poshtme, Llakocërej i Poshtëm, Elshan, Zavoj, Konjskë, Kosell, Kuraticë, Llagadin, Leskoec, Livoishtë, Lubanishtë, Openicë, Orman, Peshtan, Plaçe, Podmolë, Ramnë, Rasinë, Reçicë, Svinishtë, Sirulë, Skrebatnë, Tërpejcë dhe Shipoknë;

53. Komuna Petrovec – fshatrat: Badar, Bllacë, Breznicë, Kojnare e Epërme, Gradmanc, Divle, Kojnare e Poshtme, Katllanovë, Kozhlë, Letevc, Ognjanc, Petrovec, Rëzhaniçinë, Kojnare e Mesme, Sushicë dhe Qojli;

54. Komuna e Pehçevës – qyteti Pehçevë dhe fshatrat: Negrevë, Pançarevë, Robovë, Umlenë, Cërnik dhe Çiflik; 55. Komuna e Pllasnicës – fshatrat: Dvorc, Lisiçan, Pllasnicë dhe Pregllovë;

56. Komuna e Prilepit – qyteti Prilep dhe fshatrat: Alinc, Bellovodicë, Berovc, Beshishtë, Bonçë, Vepërçan, Veselçan, Vitolishtë, Vollkovë, Vërpsko, Galiçan, Radobil i Madh, Konjare e Madhe, Gugjakovë, Dabnicë, Dren, Dunjë, Erekovc, Zhivovë, Zagoran, Kadino Sellë, Kalen, Kanatllarc, Klepaç, Kokrë, Krushevicë, Kërstec, Lenishtë, Llopaticë, Mazhuçishtë, Radobil i Vogël, Konjare e Vogël, Ruvç i Vogël, Manastir, Marul, Nikodin, Llagovë e Re, Oreovec, Peshtan, Pletvar, Podmol, Mollçishtë, Prilepec, Prasad, Rakle, Sellcë, Smolan, Llagovë e Vjetër, Toplicë, Trojac, Topollçan, Trojkërst, Careviq, Çanishtë, Çepigovë, Çumovë, Sheleverc dhe Shtavicë;

57. Komuna e Probishtipit – qyteti Probishtip dhe fshatrat: Bunesh, Buçishtë, Gajranc, Stuboll i Epërm, Barbarevë e Epërme, Grizilevc, Gujnovc, Dobrevë, Stuboll i Poshtëm, Barbarevë e Poshtme, Dreven, Drenok, Zarepinc, Zelengrad, Zletovë, Jamishtë, Kalnishtë, Kukovë, Kundinë, Lezovë, Lesnovë, Marçin, Neokaz, Pestërshinë, Petrishinë, Pishicë, Pleshanc, Puzderc, Ratavicë, Strisovc, Stërmosh, Tripatanc, Troollë, Rudari Turk dhe Shtallkovicë;

58. Komuna e Radovishit – qyteti Radovish dhe fshatrat: Ali Koç, Ali Llobasi, Buçim, Voisllavc, Damjan, Dërzhan, Durutli, Zleovë, Injevë, Jargulicë, Kallauzli, Kallugjericë, Karalobos, Karaxhalar, Kozbunar, Koxhali, Novo Sellë, Oraovicë, Papavnicë, Pogulevë, Podaresht, Pokrajçevë, Përnali, Ralish, Sarigjol, Smilanc, Sulldurc, Supurgë, Topollnicë, Qoseli, Hudaverli, Çeshme Maallë, Shaintash, Shipkovicë dhe Shturovë;

59. Komuna e Rankovcit – fshatrat: Baratli, Betunicë, Vërzhogornc, German, Ginovc, Gulinc, Krivi Kamen, Lubincë, Millutincë, Odren, Opilë, Otoshnicë, Pëklishtë, Petralicë, Psaçë, Radibush, Rankovc dhe Stançë;

60. Komuna e Resnjës – qyteti Resnjë dhe fshatrat: Arvat, Asamat, Bollnë, Brajçinë, Vollkoder, Bella Cërkv e Epërme, Dupeni i Epërm, Krushje e Epërme, Gërçar, Bella Cërkv e Poshtme, Dupeni i Poshtëm, Perovë e Poshtme, Dërmen, Evla, Ezeran, Zllatar, Izbishtë, Ilinë, Jankovec, Kozjak, Konjskë, Kranj, Kriven, Kurbinovë, Llavc, Leva Rekë, Leskoec, Lubojnë, Nakolec, Oteshevë, Petrinë, Podmoçan, Pokërvenik, Prelubje, Pretor, Rajcë, Slivnicë, Sopotskë, Stenjë, Stiponë, Carev Dvor, Shtërbovë dhe Shullenc;

61. Komuna e Rosomanit – fshatrat: Debrishtë, Kamen Doll, Krushevicë, Manastirc, Mërzen Oraovec, Palikurë, Ribarc, Rosoman, Sirkovë dhe Tërstenik;

62. Komuna e Sveti Nikollës – qyteti Sveti Nikollë dhe fshatrat: Allakincë, Amzabegovë, Arbasanc, Bogosllavec, Burillovc, Gjulgancë e Epërme, Cërnishtë e Epërme, Gorobincë,

Delisincë, Gjugjancë e Poshtme, Cërnilishtë e Poshtme, Erxheli, Kadrifakovë, Knezhje, Krushicë, Makresh,

Malinë, Mezdrë, Meçkuevc, Mustafinë, Nemanjicë, Orel, Pavleshencë, Patetinë, Peshirovë, Preod, Rançinc, Sopot, Stanullovc, Stanjevc, Stroimanc dhe Tërstenik;

63. Komuna e Sopishtës – fshatrat: Barovë, Govërlevë, Sonjë e Epërme, Dobri Doll, Sonjë e Poshtme, Dërzhillovë, Jabollcë, Bërzenicë e Re, Patishka Rekë, Rakotincë, Sveta Petkë, Sopishtë dhe Çiflik;

64. Komuna Nagoriçi i Vjetër - fshatrat: Allgunjë, Alincë, Arbanashkë, Bajllorc, Breshkë, Bukovlan, Vojnik, Vragoturcë, Vraçevcë, Dejllovcë, Dllaboçicë, Dobraçë, Dragomancë, Drenok, Zheglan, Zheluvinë, Kanarevë, Karllovc, Koincë, Kokinë, Mëglencë, Makresh, Mallotinë, Nagoriçi i Ri, Nikulan, Obllavcë, Orah, Osife, Pelincë, Puzajkë, Ramnë, Rugjincë, Nagoriçi i Vjetër, Stepancë, Strezovc, Stërnovc, Cvetishnicë, Cvillancë dhe Çellopek;

65. Komuna e Strugës – qyteti Strugë dhe fshatrat: Bezovë, Bixhevë, Bogojc, Boroec, Bërçevë, Burinec, Veleshtë, Vishnë, Vranishtë, Gllaboçicë, Belicë e Epërme, Tatesh i Epërm, Belicë e Poshtme, Dellogozhdë, Dobovjan, Tatesh i Poshtëm, Draslajcë, Drenok, Zagraçan, Zbazhd, Jabllanicë, Kalishtë, Koroshishtë, Llabunishtë, Llakaicë, Livadhi, Llozhan, Llokovë, Llukovë, Mali Vllaj, Miseshevë, Misllodezhdë, Modriç, Moroishtë, Nerez, Novo Sellë, Oktis, Radozhdë, Ladorishtë, Frangovë, Shum, Piskupshtinë, Podgorc, Pohum, Prisovjan, Rëzhanovë, Sellc, Tashmarunishtë, Toska dhe Xhepin;

66. Komuna e Strumicës – qyteti Strumicë dhe fshatrat: Banicë, Bansko, Bellotinë, Vellusë, Vodoçë, Gabrovë, Gradsko, Balldovc, Dabilë, Dobrejç, Dorllombos, Zleshevë, Kosturinë, Kuklish, Memeshli, Murtinë, Ormanli, Popçevë, Prosenikovë, Raborc, Riç, Saçevë, Svidovicë, Tri Vodi dhe Çepeli;

67. Komuna e Studeniçanit – fshatrat: Alldincë, Batincë, Vërtekicë, Koliçan i Epërm, Koliçan i Poshtëm, Draçevicë, Ellovë, Kalldirec, Mallçishtë, Markova Sushicë, Moranë, Osinçan, Pagarushë, Ramni Gaber, Studeniçan, Umovë, Cvetovë, Cërvena Vodë dhe Cërn Vërv;

68. Komuna e Tearcës – fshatrat: Breznë, Varvarë, Glllogji, Dobrosht, Jelloshtnik, Leshkë, Neproshten, Nerasht, Odri, Përvcë, Përshovc, Sllatinë dhe Tearcë;

69. Komuna e Tetovës – qyteti Tetovë dhe fshatrat: Bozovcë, Brodec, Vejcë, Veshallë, Gajre, Reçicë e Madhe, Gjermë, Jedoarçë, Llavcë, Lisec, Reçicë e Vogël, Otunj, Poroj, Saraçinë, Sellcë, Setolë, Falish, Xhepçishtë dhe Shipkovicë;

70. Komuna Qendra – Zhupë – fshatrat: Bajramovc, Bellanc, Breshtan, Vllasiq, Papradniku i Madh, Melinçani i Epërm, Gorencë, Dollgash, Melniçan i Poshtëm, Ellvë, Elvenc, Zhitinen, Koçishtë, Koxhaxhik, Papradniku i Vogël, Novak, Osollnicë, Oxhovc, Paresh, Pralenik, Qendra-Zhupë dhe Cërno Boc;

71. Komuna e Çashkës – fshatrat: Banjicë, Bisticë, Bogomilë, Busilcë, Vlladillovc, Vitanc, Vojnicë, Gabrovnik, Gollozincë, Vranovc i Epërm, Jabollçisht i Epërm, Vranovc i Poshtëm, Jabollçisht i Poshtëm, Drenovë, Ellovec, Izvor, Kapinovë, Krajnicë, Kriva Krushë, Kërninë, Lisiçë, Martollc, Mellnicë, Mokren, Nezhillovë, Novo Sellë, Omoran, Oraov Doll, Oreshë, Otishtinë, Papradishtë, Plevenjë, Pomenovë, Popadi, Rakovec, Smillovc, Sogle, Stari Grad, Stepancë, Teovë, Creshnevë dhe Çashkë;

72. Komuna e Çeshinovës – fshatrat: Banjë, Burilçevë, Vërbicë, Zhiganc, Kuçiqinë, Lepopellc, Novo Sellan, Obleshevë, Sokollarc, Spaçevë, Teranc, Ullarc, Çeshinovë dhe Çiflik.

73. Komuna Çuçer-Sandevë – fshatrat: Banjan, Bllacë, Brazdë, Brezë, Brodec, Glluvë, Gornjan, Kuçevishtë, Mirkovc, Pobozhje, Tanushë dhe Çuçer-Sandevë;

74. Komuna e Shtipit – qyteti Shtip dhe fshatrat: Balltali, Brest, Vërsakovë, Goraçinë, Dobroshan, Dollan, Dragoevë, Edekllerc, Jamullarc, Kallapetrovc, Koshevë, Krivi Doll, Llakavicë, Leskovicë, Lipov Doll, Luboten, Nikoman, Novo Sellë, Penush, Piperovë, Poçivallë, Puhçë, Sarçievë, Sellcë, Skandallc, Sofillar, Karaorman i Vjetër, Stepancë, Suvo Gërll, Sudiq, Sushevë, Tanataarc, Testemelc, Topliq, Tri Çeshme, Haxhi-Rexhepli, Haxhi-Sejdeli, Haxhi-Hamzali, Creshkë, Çardakli, Çiflik, Shashavarli dhe Shopur;

c) Komunat në Qytetin e Shkupit

75. Komuna Aerodrom – fshati Lisiçe e Poshtme;

76. Komuna Butel – fshatrat: Vizbeg, Lubancë, Luboten dhe Radishan;

77. Komuna Gazi Babë – fshatrat: Bërnjarc, Bullaçan, Goce Dellçev, Idrizovë, Inxhikovë, Jurumler, Rashtak, Hasanbeg, Smilkovc, Stajkovc, Starçincë, Creshevë dhe Trubarevë;

78. Komuna Gjorçe Petrov – fshatrat: Vollkovë, Gračan, Kuçkovë, Nikishtan, Novo Sellë dhe Orman;

79. Komuna Karposh – fshatrat: Bardovcë dhe Nerez i Epërm;

80. Komuna Kisella Vodë - fshatrat Draçevë dhe Usje;

81. Komuna Saraj – fshatrat: Arnaki, Bojanë, Bukoviq, Gllumovë, Svillare e Epërme, Gërçec, Dvorc, Svillare e Poshtme, Kondovë, Kopanicë, Krushopek, Llaskarcë, Lubin, Matkë, Paniçar, Radushë, Raoviq, Rashçe, Miniera e Radushës, Semenishtë, Çajlanë dhe Shishevë;

82. Komuna Qendër;

83. Komuna Çair; dhe

84. Komuna Shuto Orizare – fshati Orizare e Epërme.

#### **IV. ORGANIZIMI I VETADMINISTRIMIT LOKAL NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË**

##### **Neni 13**

Në Republikën e Maqedonisë vetadministrimi vendor në mënyrë territoriale, mund të organizohet në forma të vetadministrimit vendor për rajonin e komunës, të përcaktuar me ligj, në mënyrë dhe procedurë të përcaktuara me statutin e komunës.

##### **Neni 14**

Komuna mban dhe udhëheq evidencën për format e vetadministrimit vendor që janë themeluar në rajonin e saj, sipas ligjit dhe statutit. Komuna obligohet të paraqesë ekstraktin nga evidenca për format e vetadministrimit vendor, pas themelimit të tyre, në Ministrinë kompetente të vetadministrimit lokal. Ministri kompetent i vetadministrimit lokal e përcakton formularin dhe mënyrën e mbajtjes së evidencës nga paragrafi 2 i këtij neni.

#### **V. DISPOZITAT KALIMTARE DHE PËRFUNDIMTARE**

##### **Neni 15**

Komunat ekzistuese vazhdojnë me punë deri në ditën e konstituimit të këshillave të komunave nga neni 10 i këtij ligji.

##### **Neni 16**

Komunat nga neni 10 paragrafi 1 nën b) pika 39, pika 45, pika 47 dhe 62 të këtij ligji do të funksionojnë deri në zgjedhjet lokale të vitit 2008, prej kur do të bëhen pjesë përbërëse e komunës nga neni 10 paragrafi 1 nën a) pika 14 të këtij ligji. Konstituimi i organeve dhe organizimi i komunës së posaformuar nga neni 10 paragrafi 1 nën a) pika 14 të këtij ligji, do të zbatohet sipas dispozitave të këtij kapitulli.

## **Neni 17**

Zgjedhjet për organet e komunave që do të shpallen pas hyrjes në fuqi të këtij ligji, do të bëhen për komunat nga neni 10 i këtij ligji. Qeveria e Republikës së Maqedonisë për zbatimin e zgjedhjeve nga paragrafi 1 i këtij neni, më së voni 15 ditë nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, në bazë të të dhënave zyrtare për numrin e banorëve nëpër komuna nga neni 10 i këtij Ligji në Republikën e Maqedonisë, do ta përcaktojë dhe do ta shpallë numrin e anëtarëve të këshillave të komunave nga neni 10 i këtij ligji.

## **Neni 18**

Mbledhjen konstitutive të Këshillit të Komunës nga neni 10 i këtij ligji, rajonin e së cilës e përbëjnë rajonet e dy apo më tepër komunave ekzistuese, do ta konvokojë kryetari i Këshillit nga përbërja paraprake e komunës ekzistuese, në rajonin e së cilës gjendet selia e komunës nga neni 10 i këtij ligji.

## **Neni 19**

Komuna nga neni 10 i këtij ligji, rajonin e së cilës e përbëjnë rajonet e dy apo më tepër komunave ekzistuese, e

merr pajisjen, inventarin dhe punët tjera, arkivin, dokumentacionin, mjetet e punës dhe mjetet e fondeve komunale, ndërmarrjet publike dhe institucionet publike dhe të drejtat e tjera dhe obligimet e komunave ekzistuese.

Komuna nga neni 10 i këtij ligji, rajonin e së cilës e përbëjnë rajonet e dy apo më tepër komunave ekzistuese, i merr të punësuarit që kanë themeluar marrëdhënie pune në komunat ekzistuese deri në ditën e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

## **Neni 20**

Komuna nga neni 10 i këtij ligji, rajonin e së cilës e përbëjnë rajonet e dy apo më tepër komunave ekzistuese, i merr obligimet e komunave ekzistuese deri në lartësinë e mjeteve të siguruar në buxhetet e komunave për vitin vijues dhe të hyrave të tjera sipas ligjit.

## **Neni 21**

Komuna nga neni 10 i këtij ligji, rajonin e së cilës e përbëjnë rajonet e dy apo më tepër komunave ekzistuese, e nxjerr statutin e komunës dhe aktet për organizimin dhe sistematizimin e administratës komunale, më së voni në afat prej 60 ditësh nga dita e konstituimit të këshillit komunal.

Dispozitat e komunave ekzistuese, rajonet e së cilave e përbëjnë rajonin e njërit nga komunat nga neni 10 i këtij ligji, vazhdojnë të zbatohen për rajonet për të cilat janë nxjerrë, deri në nxjerrjen e dispozitave të komunës nga neni 10 i këtij ligji.

## **Neni 22**

Komunat ekzistuese, rajonet e së cilave e përbëjnë rajonin e njërit nga komunat nga neni 10 i këtij ligji, do t'i mbyllin librat zyrtarë përfundimisht me ditën e konstituimit të këshillit komunal nga neni 10 i këtij ligji. Vulat, vulat katrore dhe protokollat e komunave ekzistuese rajonet e të cilave e përbëjnë rajonin e njërit nga komunat nga neni 10 i këtij ligji, i merr komuna nga neni 10 i këtij ligji dhe me ato vepron sipas ligjit. Lëndët e pakryera të organeve të komunave ekzistuese, rajonet e së cilave e përbëjnë rajonin e njërit nga komunat nga neni 10 i këtij ligji, i merr komuna nga neni 10 i këtij ligji.

### **Neni 23**

Të hyrat dhe të dalat e buxheteve të komunave ekzistuese, rajonet e të cilave e përbëjnë rajonin e njëjës nga komunat nga neni 10 i këtij ligji, bëhen pjesë përbërëse e buxhetit të komunës nga neni 10 i këtij ligji.

### **Neni 24**

Komuna nga neni 10 i këtij ligji, rajonin e së cilës e përbëjnë rajonet e dy apo më tepër komunave ekzistuese, obligohet t'i përgatisë dhe miratojë llogaritë vjetore për ato komuna.

### **Neni 25**

Komuna nga neni 10 i këtij ligji, i merr të drejtat e themelimit të ndërmarrjeve publike me veprimtari komunale dhe institucioneve të tjera publike, të themeluara nga komunat, rajonet e së cilave e përbëjnë rajonin e komunës nga neni 10 i këtij ligji.

### **Neni 26**

Komuna nga neni 10 i këtij ligji, rajonin e së cilës e përbëjnë rajonet e dy apo më tepër komunave ekzistuese, siguron funksionimin e administratës ekzistuese të komunës në ato rajone, si pjesë përbërëse të administratës së saj komunale. Komuna nga neni 10 i këtij ligji, rajonin e së cilës e përbëjnë rajonet e dy apo më tepër komunave ekzistuese, nxjerr aktin me të cilin i përcakton punët që do t'i kryejë administrata komunale për atë rajon. Akti nga paragrafi 2 i këtij neni do të nxirret në afat prej 60 ditësh, nga dita e konstituimit të Këshillit Komunal nga neni 10 i këtij ligji.

### **Neni 27**

Komuna nga neni 10 i këtij ligji, për sigurimin e kryerjes së kompetencave, mund të lidhë marrëveshje për bashkëpunim funksional me komunën fqinje, ose marrëveshje për formimin e shërbimit të përbashkët publik. Nëse komuna nga neni 10 i këtij ligji, nuk siguron zbatimin e kompetencave, ose nuk e lidh marrëveshjen nga paragrafi 1 i këtij neni, Republika do ta sigurojë zbatimin e kompetencave në emër dhe për llogari të komunës.

### **Neni 28**

Komuna nga neni 10 i këtij ligji, në statutin e komunës do të përcaktojë cilat nga kompetencat e prefektit mund t'i delegohen kryetarit të Këshillit të vetadministrimit vendor dhe do ta rregullojë mënyrën e sigurimit të mjeteve për kryerjen e atyre punëve.

### **Neni 29**

Formulari dhe mënyra e mbajtjes së evidencës nga neni 14 paragrafi 3 të këtij ligji, do të miratohet në afat prej 3 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### **Neni 30**

Organi kompetent për punët e matjes dhe kadastrës të patundshmërive, në afat prej 9 muajsh nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji, do t'i përcaktojë kufijtë e komunave kadastrale të vendbanimeve dhe kufijtë e komunave nga neni 10 i këtij ligji, me përskrim dhe skica të atyre kufijve.

### **Neni 31**

Qyteti i Shkupit dhe komunat nga neni 10 i këtij ligji, me seli në qytet, obligohen t'i harmonizojnë planet e përgjithshme urbanistike me dispozitat e këtij ligji, në afat prej një viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji.

### **Neni 32**

Me ditën e fillimit të zbatimit të këtij ligji, nuk vlen Ligji për ndarjen territoriale të Republikës së Maqedonisë dhe përcaktimin e rajoneve të njësisve të vetadministrimit lokal ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 49/96) dhe Ligji për rregullimin e marrëdhënieve ndërmjet njësisve të reja të vetadministrimit lokal dhe njësisve të vetadministrimit lokal nga të cilat dalin ("Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë" numër 59/96).

### **Neni 33**

Ky ligj hyn në fuqi në ditën e ardhshme nga dita e shpalljes në "Gazetën zyrtare të Republikës së Maqedonisë", ndërsa do të zbatohet pas zgjedhjeve të ardhshme lokale.